



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.2

2005

18 janar

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.4, datë 7.1.2005	Për transferimin në pronësi të komunës Prezë, Tiranë të mjediseve të ish-repartit ushtarak nr.3800/1, batalioni “AKA” në Prezë, Tiranë, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	67
Vendim i KM nr.7, datë 7.1.2005	Për miratimin e strategjisë për nxitjen e punësimit në administratën publike të studentëve të diplomuar jashtë vendit.....	67
Vendim i KM nr.8, datë 7.1.2005	Për miratimin e strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuar ...	68
Vendim i KM nr.21, datë 7.1.2005	Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të pagave të punonjësve të Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave dhe të komisioneve vendore.....	68
Vendim i KM nr.22, datë 7.1.2005	Për transferimin në pronësi të bashkisë së Fierit të mjediseve të ish-spitalit ushtarak, Fier, të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”.....	77

Vendim i AMS nr.10, datë 12.1.2005	Për delegimin e disa kompetencave të Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, Drejtorit Ekzekutiv.....	78
Udhëzim i AMS nr.2, datë 12.1.2005	Për zbatimin e vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Sigurimeve nr.10, datë 12.1.2005 “Për delegimin e disa kompetencave të Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, Drejtorit Ekzekutiv”.....	79

VENDIM
Nr.4, datë 7.1.2005

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KOMUNËS PREZË, TIRANË TË REPARTIT USHTARAK NR.3800/1, BATALIONI “AKA” NË PREZË, TIRANË, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËTËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-repartit ushtarak nr.3800/1, batalioni “AKA” në Prezë, Tiranë të kalojnë në pronësi të komunës Prezë, Tiranë, për t’u përdorur për shërbimet sociale të komunitetit të kësaj komune.
 2. Prona me numër rendor 210 “Ish reparti ushtarak nr.3800/1, batalioni “AKA”” në Prezë, Tiranë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.
 3. Komunës Prezë, Tiranë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim.
 4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i komunës Prezë, Tiranë, të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.7, datë 7.1.2005

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË PËR NXITJEN E PUNËSIMIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE TË STUDENTËVE TË DIPLOMUAR JASHTË VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e strategjisë për nxitjen e punësimit në administratën publike të studentëve të diplomuar jashtë vendit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.8, datë 7.1.2005

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë kombëtare për personat me aftësi të kufizuar.
2. Ngarkohen Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit, Ministria e Financave, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e kësaj strategjie. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.21, datë 7.1.2005

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË KOMITETIT SHTETËROR PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE DHE TË KOMISIONEVE VENDORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “d” të nenit 16 të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave është sipas skemës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Organika e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave është sipas skemës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Struktura e komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave është sipas skemës 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Organika e komisionit vendor për kthimin dhe kompensimin e pronave Tiranë është sipas skemës 2/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Organika e komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave në qarqet Durrës, Korçë, Vlorë, Fier, Lezhë dhe Shkodër është sipas skemës 2/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
6. Organika e komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave në qarqet Berat, Dibër, Elbasan, Gjirokastrë dhe Kukës është sipas skemës 2/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
7. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave dhe të komisioneve vendore është 160 veta.
8. Strukturat dhe nivelet e pagave për nëpunësit e Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave dhe të komisioneve vendore është sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
9. Paga e grupit (kolona 1) e lidhjes nr.1-Diplomë e shkollës së lartë-është 9 000 (nëntë mijë) lekë.

10. Shtesa për vjetërsi pune (kolona 2) jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

11. Shtesa për kualifikim (kolona 3) është 0 (zero).

12. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1.

13. Nivelet e pagave për nëpunësit e kabinetit të kryetarit të Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave dhe për kryetarin e anëtarët e komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave, janë si më poshtë vijon:

a) Në Komitetin Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave:

- Këshilltar	83 000 lekë
- Zëdhënës shtypi	49 000 lekë
- Sekretar	29 000 lekë.

b) Në komisionet vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave:

- Kryetari	55 000 lekë
- Anëtar	49 000 lekë.

14. Punonjësit e tjerë të Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave dhe të komisioneve vendore për kthimin dhe kompensimin e pronave të paguhen sipas lidhjes II-5 “Paga bazë sipas klasave për punonjësit e ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore” të vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

15. Për pagat e caktuara sipas këtij vendimi, të zbatohet indeksi i përcaktuar në vendimin nr.184, datë 10.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për masën e indeksimit të pagave për vitin 2004” dhe rregullat e përcaktuara në vendimin nr.74, datë 12.2.2004 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e indeksimit të pagave”.


16. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Komitetit Shtetëror për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

SKEMA 1

STRUKTURA E KOMITETIT SHETEROR PER KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE




SKEMA 2

**ORGANIKA E KOMITETIT SHETEROR TE KTHIMIT DHE
KOMPENSIMIT TE PRONAVE**

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I. KRYETARI		<u>1</u>
KABINETI		<u>3</u>
KESHILLTAR		2
SEKRETAR		1
II. ANETAR KOMITETI		4
ZEDHENES SHTYPI		1
SEKRETAR		2
III. DREJTORIA E APELIMIT DHE KONTROLLIT		<u>(10)</u>
DREJTOR		1
SEKTORI I APELIMIT		<u>(5)</u>
PERGJEGJES SEKTORI	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	4
SEKTORI I KONTROLLIT		<u>(4)</u>
PERGJEGJES SEKTORI	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	3

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
III. DREJTORIA E VLERESIMIT DHE KOMPENSIMIT		(7)
DREJTOR		1
SEKTORI I VLERESIMIT		(3)
PERGJEGJES SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I KOMPENSIMIT		(3)
PERGJEGJES SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	IV-a	2
VII. DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE FINANCES		(20)
DREJTOR		1
SEKTORI I FINANCES		(3)
PERGJEGJES SEKTORI	III-b	1
SPECIALIST BUXHETI	IV-b	1
SPECIALIST	IV-b	1
SEKTORI I PERSONELIT DHE SHERBIMEVE		(12)
PERGJEGJES SEKTORI	III-b	1
SPECIALIST SHERBIMESH	IV-b	1
SPECIALIST IT	IV-b	1
TEKNIK MIREMBAJTJE/MAGAZINIER		1
SHOFER		6
PUNETOR PASTRIMI		1
NEPUNES INFORMACIONI		1
SEKTORI I ANKESAVE DHE ARKIVIT		(4)
PERGJEGJES SEKTORI	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	2
PROTOKOLLIST		1
PUNONJES GJITHSEJ		(48)

STRUKTURA E KOMISIONEVE VENDORE TE KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TE PRONAVE



SKEMA 2/1

**ORGANIKA E KOMISIONIT VENDOR TE KTHIMIT DHE
KOMPENSIMIT TE PRONAVE TIRANE**

KRYETARI	1
ANETAR	4
SPECIALIST	5
SEKRETAR/ARKIVIST	1
SHOFER	1
PUNONJES GJITHSEJ	12

**ORGANIKA E KOMISIONEVE VENDORE TE KTHIMIT DHE
KOMPENSIMIT TE PRONAVE NE QARQET DURRES, KORÇE, VLORE, FIER, LEZHE, SHKODER**

KRYETARI	1
ANETAR	4
SPECIALIST	3
SEKRETAR/ARKIVIST	1
SHOFER	1
PUNONJES GJITHSEJ	10

SKEMA 2/3

**ORGANIKA E KOMISIONEVE VENDORE TE KTHIMIT DHE
KOMPENSIMIT TE PRONAVE NE QARQET BERAT, DIBER, ELBASAN, GJIROKASTER, KUKES**

KRYETARI	1
ANETAR	4
SPECIALIST	1
SEKRETAR/ARKIVIST	1
SHOFER	1

<u>PUNONJES GJITHSEJ</u>	8
---------------------------------	----------

LIDHJA NR. 1

Emertimi	KATEGORITE	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
	1	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore per Vjetersi (SHK)	Shtesa per Kualifikim (SHP)	Shtesa per Pozicion (SHP) leke
Drejtor drejtorie	II-b	9 000	2%	0	74.000
Pergjegjes sektori ne Komitetin Shteteror te Kthimit dhe Kompensimit te Pronave.	III-a	9 000	2%	0	55 000
Pergjegjes sektori ne Komitetin Shteteror. Specialist i nivelit te larte ne Komitetin Shteteror.	III-b	9 000	2%	0	40 000
Specialist i nivelit te mesem ne Komitetin Shteteror.	IV-a	9.000	2%	0	30.000
Specialist ne Komitetin Shteteror. Specialist ne komisionet vendore	IV-b	9000	2%	0	20.000

VENDIM**Nr.22, datë 7.1.2005**

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË FIERIT TË MJEDISEVE TË ISH-SPITALIT USHTARAK, FIER, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mjediset e ish-spitalit ushtarak në Fier të kalojnë në pronësi të bashkisë së Fierit për t’u përdorur për shërbimet sociale të komunitetit të kësaj bashkie.

2. Prona me numër rendor 838 “Ish-spitali ushtarak, Fier” të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Fierit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit,

kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Fierit të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.10, datë 12.1.2005

PËR DELEGIMIN E DISA KOMPETENCAVE TË KËSHILLIT TË AUTORITETIT
MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE, DREJTORIT EKZEKUTIV

Në mbështetje të kreut II nenet 27 e vijues të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, të shkronjave “ç”, “j” dhe “k” të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve”, me qëllim marrjen e vendimeve sa më të shpejta dhe operative në funksion të mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

VENDOSI:

1. Delegimin e disa kompetencave të Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, Drejtorit Ekzekutiv, i cili i ushtron këto kompetenca në bazë dhe për zbatim të legjislacionit në fuqi në fushën e sigurimeve dhe risigurimeve.

2. Kompetencat e deleguara janë si më poshtë vijon:

- a) Tërheqjen e licencës (autorizimit zyrtar) të agentëve në sigurime;
- b) Vendosjen e sanksioneve në përputhje me ligjin nr.9267, datë 29.7.2004 dhe sipas udhëzimit bashkëlidhur këtij vendimi;
- c) Miratimin e kontratave të reja të sigurimit që shoqëritë e sigurimit kërkojnë të hedhin në treg.

3. Drejtori Ekzekutiv nxjerr urdhra në zbatim të këtij vendimi. Një kopje për çdo akt të nxjerrë depozitohet te Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

4. Drejtori Ekzekutiv informon për çdo rast Këshillin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve lidhur me masat e marra në zbatim të kompetencave të deleguara.

5. Në zbatim të këtij vendimi, Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve miraton udhëzimin bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KËSHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba

UDHËZIM
Nr.2, datë 12.1.2005

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE NR.10,
DATË 12.1.2005 “PËR DELEGIMIN E DISA KOMPETENCAVE TË KËSHILLIT TË

AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE, DREJTORIT EKZEKUTIV"

Në mbështetje të nenit 31 pika 1 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative", të shkronjës "k" të pikës 2 të nenit 14 të ligjit nr.9268, datë 29.7.2004 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve", Këshilli i Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve

UDHËZON:

1. Në zbatim të pikës 2 /a të vendimit nr.10, datë 12.1.2005 të Këshillit, Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë t'ia tërheqë licencën (autorizim zyrtar) agjentit në sigurime për rastet e parashikuara në nenin 85, 100, 120, 156, 161, 162 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 kur:

a) agjenti nuk fillon veprimtarinë e ndërmjetësimit brenda 6 muajve nga data e marrjes së licencës;

b) agjenti vullnetarisht heq dorë nga ushtrimi i veprimtarisë së ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime;

c) vërtetohet se dokumentet për dhënien e licencës agjentit janë të falsifikuara ose të rreme;

ç) agjenti e ushtron veprimtarinë e tij në kundërshtim me interesat e të siguruarve;

d) agjenti ka shkelur dispozitat e ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;

dh) agjenti qëllimisht ka ofruar informacion të rremë për të siguruarit ose për "Autoritetin";

e) agjenti nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar gjatë ushtrimit të kontrollit nga "Autoriteti";

ë) agjenti shkel dispozitat e parashikuara për "Mbrojtjen konsumatore" të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

f) agjenti kryen me veprimtarinë e tij veprime mashtruese;

g) agjenti nuk zbaton primin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, të përcaktuar nga Ministri i Financave.

1.1 Vendimi i "Autoritetit" për tërheqjen e licencës botohet në dy gazeta me qarkullim kombëtar brenda 5 ditëve nga data e marrjes së vendimit.

1.2 Shoqëria e sigurimit dhe dega e shoqërisë së huaj detyrohen të zgjidhin kontratën me agjentin, në rast se ndërmjetësit i është tërhequr licenca.

2. Në zbatim të pikës 2 /b të vendimit nr.10, datë 12.1.2005 të Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të vendosë sanksione me gjobë nga 200 000 -300 000 lekë ndaj agjentit në sigurime për moszbatim të ligjit për sigurimin e detyrueshëm dhe ligjin nr.9267, datë 29.7.2004, sipas neneve 77, 100, 120, 166 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, kur:

a) agjenti nuk zbaton ligjin për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;

b) agjenti nuk zbaton primin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta, të përcaktuar nga Ministri i Financave;

c) agjenti në sigurime ushtron veprimtari për më shumë se një shoqëri sigurimi apo degë të shoqërisë së huaj, me përjashtim kur në kontratën midis agjentit dhe shoqërisë së sigurimit apo degës së shoqërisë së huaj, parashikohet ndryshe;

d) agjenti ka autorizuar një person tjetër që të nënshkruajë kontratën e sigurimit në emër dhe për llogari të tij;

e) agjenti nuk zbaton vendimin e Këshillit të Ministrave "Për licencimin e agjentit në sigurime, si dhe rregullat e mbikëqyrjes së tyre";

f) agjenti nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar gjatë ushtrimit të kontrollit nga "Autoriteti".

3. Në zbatim të pikës 2/b të vendimit nr.10, datë 12.1.2005 të Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të vendosë sanksione me gjobë ndaj shoqërisë së sigurimit në masën 1 500 000 lekë për shkelje të parashikuara në ligjin për sigurimin e detyrueshëm dhe ligjin nr.9267, datë 29.7.2004, sipas nenit 165 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 si më poshtë:

a) kur shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari në kundërshtim me dispozitat e neneve 4 e 9 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

b) kur shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari sigurimi në kundërshtim me nenin 20 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

c) kur dega e shoqërisë së huaj ushtron veprimtari sigurimi në kundërshtim me dispozitat e paragrafit të parë të nenit 22 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

ç) kur shoqëria e sigurimit vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 112 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

d) kur shoqëria e sigurimit nuk respekton dispozitat e neneve 101, 102, 103, 104 e 105 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 dhe aktet nënligjore të nxjerra nga “Autoriteti” në zbatim të tyre;

dh) kur shoqëria e sigurimit nuk respekton dispozitat e parashikuara në nenet 107 e 108 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

e) kur shoqëria e sigurimit nuk ka nivelin e kërkuar të aftësisë paguese të parashikuar në dispozitën e nenit 97 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

ë) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitën e nenit 98 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

f) kur shoqëria e sigurimit nuk ka respektuar dispozitën e paragrafit të parë të nenit 43, të paragrafit të parë të nenit 44, nenit 46, paragrafit të parë të nenit 51, paragrafit të parë të nenit 54, neneve 55, 56 dhe 58 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

g) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e neneve 115, 116, 117 e 118 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

gj) kur shoqëria e sigurimit nuk ka organizuar kontrollin e brendshëm dhe ka shkelur dispozitat e paragrafit të parë të nenit 69 e të neneve 70 dhe 71 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

h) kur shoqëria e sigurimit nuk ka raportuar në “Autoritet”, sipas parashikimeve të dispozitave të paragrafit të parë të nenit 122 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

i) kur shoqëria e sigurimit nuk ka bashkëpunuar me “Autoritetin” për ushtrimin e mbikëqyrjes, parashikuar në dispozitat e paragrafit të tretë të nenit 121 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

j) kur shoqëria e sigurimit nuk ka respektuar dispozitat e paragrafit të pestë të nenit 100 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

k) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e nenit 75 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

l) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e nenit 95 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

ll) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e nenit 111 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

3.1 Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të vendosë sanksione me gjobë nga 300 000-400 000 lekë ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit për shkelje të parashikuara në pikën 1 të nenit 165 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

3.2 Përveç sa është parashikuar në pikën 3.1 të këtij udhëzimi, Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të pezullojë personin përgjegjës nga funksioni që mban në shoqërinë e sigurimit për një periudhë njëvjeçare, bazuar në nenin 165 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

3.3 Pavarësisht nga sa është parashikuar në pikën 3.2 të këtij udhëzimi, për rastet e pezullimit të drejtorit të përgjithshëm të shoqërisë së sigurimit, Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit për këtë sanksion merr më parë miratimin nga Këshilli i Autoritetit.

3.4 Për vendosjen e sanksioneve për shkeljet e parashikuara në pikën 1 të nenit 165 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 dhe pikën 3 të këtij udhëzimi mbi masën 1 500 000 lekë duhet të merret miratimi i Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve.

4. Në zbatim të pikës 2/b të vendimit nr.10, datë 12.1.2005 të Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të vendosë sanksione ndaj shoqërisë së sigurimit me gjobë nga 800 000-1 000 000 lekë parashikuar në nenin 165 pika 2 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, si më poshtë:

a) kur shoqëria e sigurimit nuk ka raportuar te “Autoriteti” sipas dispozitave të parashikuara në nenin 72 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

b) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e parashikuara në nenin 59 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

c) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e parashikuara në paragrafin e tretë të nenit 100 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

ç) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e paragrafit të dytë të nenit 82 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

d) kur shoqëria e sigurimit nuk ka respektuar dispozitat e parashikuara në paragrafin e katërt të nenit 84 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

dh) kur shoqëria e sigurimit nuk ka respektuar dispozitat e parashikuara në paragrafin e gjashtë të nenit 89 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

e) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e parashikuara në nenin 109 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004;

ë) kur shoqëria e sigurimit ka shkelur dispozitat e parashikuara në nenet 156, 158, 159 e 160 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

4.1 Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të vendosë sanksione me gjobë nga 100 000-200 000 lekë ndaj personit përgjegjës të shoqërisë së sigurimit për shkeljet e parashikuara në pikën 2 të nenit 165 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 .

4.2 Përveç sa është parashikuar në pikën 4.1 të këtij udhëzimi, Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të pezullojë personin përgjegjës nga funksioni që mban në shoqërinë e sigurimit për një periudhë njëvjeçare bazuar në nenin 165 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

4.3 Pavarësisht nga sa është parashikuar në pikën 4.2 të këtij udhëzimi, për rastet e pezullimit të drejtorit të përgjithshëm të shoqërisë së sigurimit, Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit për këtë sanksion merr më parë miratimin nga Këshilli i Autoritetit.

5. Në zbatim të pikës 2/b të vendimit nr.10, datë 12.1.2005 të Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të vendosë sanksione ndaj shoqërisë së sigurimit, të parashikuara në nenin 169 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004, si më poshtë:

a) Sanksion me gjobë nga 100 000 - 150 000 lekë ndaj shoqërisë së sigurimit që ka shkelur dispozitat e nenit 161 të këtij ligji.

b) Sanksione me gjobë nga 20 000-50 000 lekë ndaj personave përgjegjës të shoqërisë së sigurimit që kanë shkelur dispozitat e paragrafit të parë të nenit 162 të këtij ligji.

c) Sanksione me gjobë nga 50 000-100 000 lekë ndaj agentëve a shoqërive të brokerimit që kanë shkelur dispozitat e nenit 161 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

e) Sanksione me gjobë nga 10 000-30 000 lekë ndaj agentit, brokerit, personave përgjegjës të shoqërisë së agentëve dhe shoqërisë së brokerimit që kanë shkelur dispozitat e paragrafit të parë të nenit 162 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004.

6. Në zbatim të pikës 2/c të vendimit nr.10, datë 12.1.2005 të Këshillit të Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve, Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të miratojë kontratat e reja të sigurimit që shoqëria e sigurimit kërkon të hedhë në treg. Ky miratim bëhet brenda 1 muaji nga paraqitja e produktit në Autoritetin Mbikëqyrës të Sigurimeve.

7. Të gjitha sanksionet e vendosura nga Drejtori Ekzekutiv, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi, duhet të mbështeten në konstatimet e rezultuara nga ushtrimi i kontrolleve në vend dhe atij dokumentar të kryera në shoqëritë e sigurimit apo agentët e tyre.

8. Vendimi i Drejtorit Ekzekutiv për vendosjen e sanksioneve apo tërheqjen e licencës (autorizimit zyrtar) agentëve në sigurime ankimohet në përputhje me parashikimet e neneve 135 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative.

**KRYETARI I KESHILLIT
TË AUTORITETIT MBIKËQYRËS TË SIGURIMEVE
Burbuqe Riba**

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 18.1.2005

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 100 lekë